

Akt Themelimi
i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar “**ABE COMPANY**”

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë , në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 , “ Për shoqëritë tregtare” dhe në Ligjin Nr.9723 , datë 03.05.2007 “Për Q.K.R” dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqërite Tregtare , me vullnetin e tyre të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, sot më datë 23/03/2022 me ortakët :

1. **Eduart SHEHU i pajisur me ID Nr H70702056N**
2. **Nertila SHEHU i pajisur me ID Nr I55606107S**

krijojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “**ABE COMPANY**” me akt themelimi si vijon:

Neni 1

Formimi i shoqërisë

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “**ABE COMPANY**”. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar , ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

Neni 2

Selia e shoqërisë

- Selia e shoqërisë “**ABE COMPANY**” do të jetë:Vlore, Rruga Gjergj Kastrioti, Lagjia 24 Maji, Pallati "Anakonda", Hyrja Nr.2.
- Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:
abecompany.al@gmail.com

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 3

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtaritë si vijojnë:

- Tregti me shumicë dhe pakicë e materialeve të ndertimit. Zhvillimi dhe kryerja e aktivitetit të shërbimeve të ndryshme, hotelerisë, restoranteve, aktivitet turistik, transportues, menaxhimit, konsulencës dhe studimeve të të gjitha llojeve. Kryerja e investimeve në të gjitha fushat dhe kryesisht në atë të hotelerisë. Investimi i kapitalit dhe i mjeteve të tjera financiare për blerje pasurish të luajtshme dhe të paluajtshme dhe në vazhdimësi të aktiviteteve të saj, shitja e tyre, blerja, marrja hua për të arritur qëllimet e Shoqërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat 20 (njetzet) vjeçar . Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë private “**ABE COMPANY**” do të jetë 100 (njeqind) Lek dhe është i ndarë në aksione në përputhje me ligjin.

1. Ortaku themelues **Eduart SHEHU**: Zotërues i një kuote te vetme që përbën 50% te kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Nertila SHEHU**: Zotërues i një kuote te vetme që përbën 50% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Drejtimi i shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori z. **Eduart SHEHU**. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj .

Cdo kontrate do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posacme .

Neni 7

Ortakët themelues kanë të drejte të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale, kanë të drejtë të caktojnë financiere dhe likuidatorë për problemet e shoqërisë.

Neni 8

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë .

Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 10

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Neni 11

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje , për t'ju shperndare organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “**ABE COMPANY**”.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm .

Ortaku i “**ABE COMPANY**”

Eduart SHEHU



Ortaku i “**ABE COMPANY**”

Nertila SHEHU

